Republika e Kosovës

Republika Kosovo - Republic of Kosovo

Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA VII
Sesioni vjeshtor
Komisioni për Integrime Evropiane
Mbledhja nr. 14
Prishtinë, më 03.12.2020, në orën 10:00

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Ismet Beqiri, Veton Berisha, Gazmend Gjyshinca, Faton Bislimi, Blerta Deliu-Kodra, Uran Ismaili dhe Haxhi Shala.

Munguan: Branislav Nikoliq, Arbëresha Kryeziu-Hyseni dhe Fitore Pacolli-Dalipi.

Stafi mbështetës i komisionit: Ahtere Loxha dhe Safet Beqiri.

Mbledhjen e kryesoi: Ismet Beqiri, kryetar i Komisionit

Kryetari i komisionit pasi konstatoi se janë plotësuar kushtet për punë e hapi mbledhjen:

Rendi i ditës

1. **Miratimi i rendit të ditës;**
2. **Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e datës 22.10.2020 dhe 03.11.2020;**
3. **Shqyrtimi i Projektligjit nr. 07/L-016 për rimëkëmbjen ekonomike – COVID-19, me amendamentet e Komisionit Funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;**
4. **Shqyrtimi i Projektligjit nr. 07/L-029 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-089 për deminim humanitar, me amendamentet e Komisionit Funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;**
5. **Të ndryshme.**

1. Miratimi i Rendit te ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e datës 22.10.2020 dhe 03.11.2020

Procesverbalet u miratuan pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Projektligjit nr.07/L-016 për rimëkëmbjen ekonomike – COVID-19, me amendamentet e Komisionit Funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së

Kryetari: tha se Projektligji nr. 07/L-016 për rimëkëmbje ekonomike – COVID-19, së bashku me Raportin plotësues me amendamente të Komisionit Funksional për Buxhet dhe Transfere, nuk e harmonizon dhe përafron legjislacion të veçantë të BE-së për rimëkëmbje ekonomike për Covid-19, por kjo çështje është kompetencë e përbashkët e shteteve anëtare të BE-së. Për rrjedhojë, ky projektligj nuk është në kundërshtim dhe nuk i tejkalon dispozitat e Acquis të BE-së dhe mund te rekomandohet për miratim ne Kuvend.

Pasi nuk pati diskutues të paraqitur, kryetari e hodhi ne votim Projektligjin dhe raportin plotësues me amendamentet e Komisionit Funksional.
Pas votimit, kryetari konstatoi se Komisioni me shumicë votash nxori këtë;

Rekomandim

Projektligji nr.07/L-016 për rimëkëmbjen ekonomike – COVID-19, së bashku me amendamentet e Komisionit Funksional (Raportin plotësues) nuk është në kundërshtim me legjislacionin e BE-së dhe i rekomandon Kuvendit për miratim.

4. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 07/L-029 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-089 për deminim humanitar, me amendamentet e Komisionit Funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së

Kryetari: tha se para nesh kemi shqyrtimin e Projektligjit 07/L-029 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-089 për deminim humanitar, me raportin e Komisionit Funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së.
Ky projektligj nuk ka amendamente të propozuara nga Komisioni funksional, çështjet e adresuara në këtë projektligj nuk janë të rregulluara me legjislacionin e BE-së, pra të Acquis , dhe si e tillë kjo fushë është kompetencë e brendshme e shteteve anëtare të BE-së.

Andaj, ky projektligj mund të rekomandohet për miratim në Kuvend.

Pasi nuk pati diskutues të paraqitur, kryetari e hodhi ne votim Projektligjin.
Pas votimit, kryetari konstatoi se komisioni njëzëri nxori këtë:

Rekomandim

Projektligjit nr. 07/L-029 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-089 për deminim humanitar, nuk është në kundërshtim me legjislacionin e BE-së dhe i rekomandon Kuvendit për miratim.

5. Të ndryshme

Pasi nuk pati diskutues te paraqitur, kryetari e shpalli të mbyllur mbledhjen e Komisionit.

Mbledhja përfundoi në orën 10:20.

E përgatiti **Ismet Beqiri,**

Kryetari i Komisionit

Stafi mbështetës i Komisionit